

VENDIM
Nr.7, date 9.4.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.254, DATË 27.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIAREPËR TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË
ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE E TË
PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA GJATË PERIUdhËS SË
FATKEQËSISË NATYRORE, TË SHPALLUR SI PASOJË E COVID-19”**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 9.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin Këshillit të Ministrave për ndryshimin e vendimit nr.254, datë 27.3.2020, me këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 2 dhe 3, të kreut II, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“2. Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vetëpunësuarit/të punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se në një listëpagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrenguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale.

Në rastin kur vetëm një prej aktivitetëve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se në një listëpagesë, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.

3. Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, sipas kategorizimit të mëposhtëm:

- a) Personat fizikë të vetëpunësuar;
- b) Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;
- c) Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;
- ç) Të punësuarit në personat juridikë.”.

b) Pas pikës 5, të kreut II, të shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Nuk përfitojnë ndihmë financiare individët e vetëpunësuar/punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë.”.

c) Në pikën 1, të kreut V, vlera “... 5 850 000 000 (pesë miliardë e tetëqind e pesëdhjetë milionë) lekë ...” të ndryshohet dhe të bëhet “... 6 416 000 000 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTORROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**